

VENDIM
Nr. 835, datë 3.12.2014

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA , NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “THE STAR” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “SALLË
PRODHIMI NË KATIN E KATËRT NË PRODHIM VESHJE, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “The Star” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore “Sallë prodhimi në katin e katërt në Prodhim Veshje, Durrës”, me sipërfaqe të përgjithshme 524 (pesëqind e njëzet e katër) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama